

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KONSUMATORE

1. Detajet e Institucionit Kredidhënës

Institucioni financiar I mikrokredisë Adresa Numri i telefonit Adresa e postës elektronike Adresa e web-it	Micro Credit Albania shpk (MCA) Rr.Reshit Petrela Tirana, Albania Tel: +355 4 2 238 092 Mob: +355 68 40 55 570 www.mca.al
--	---

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i kredisë	Qëllimi i kesaj kredie është për të lehtësuar blerjen e të mirave konsumatore si psh pajse elektronike, mobilie, paisje për ajër të kondicionuar etj dhe te mirave jo të prekshme ne arsim, shëndetësi, pushime, per te financuar riparime te vogla ne shtëpi. Kredia konsumatore nuk mund të jepet për investime financiare apo qëllime lojrash fati. Klienti duhet të ketë burim te sigurt të ardhurash si paga, të ardhurat nga biznesi, të ardhurat nga kontratat e qerasë kur këto janë të deklaruara. Institucioni financon 100% te nevojave të klientit brenda shumave limit të përcaktuara për këtë produkt.
Vlera totale e kredisë dhe monedha	Kredia konsumatore lëvrohet vetëm në LEK. Shuma minimale e kësaj kredie është 30,000 Lek Shuma maksimale e kësaj kredie është 2 500 000 Lek
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve	Kredia do të lëvrohet me kërkesë të kredimarrësit në një shumë të vetme nëpërmjet çekut ose në një llogari bankare të vetë klientit vetëm pasi ky i fundit të ketë përmbushur kërkesat e institucionit para lëvrimit të fondeve dhe sipas ligjeve ne fuqi.
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Afati maksimal për kredinë konsumatore është 60 muaj
Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet	Plani i amortizimit të kredisë merret në degët tona sipas kërkesave të paraqitura nga klienti dhe kushteve të institucionit në momentin e aplikimit. Plani nuk përbën detyrim ligjor as për klientin dhe as për MCA.
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar	Totalit të koston së kredisë per klientin përfshin: - Shuma e fondeve te disbursuara + Shuma e Interesave - Komision administrimi Vlerat e seciles pjesë së kostove janë të detajuara në paragrafin 3
Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme	Bashkëhuamarres apo garantor. Nuk kerkohet garanci/kolateral hipotekor

3. Kostoja e kredisë

Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë	Klienti do të paguajë interes mbi shumën e disbursuar dhe të pashlyer te kredisë ne vlerën 1-5%
Norma efektive e interesit (NEI)	Norma efektive e interesit NEI është totali i koston së kredisë për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë. Kostoja totale e kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe cdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan për kredinë sipas kushteve te marrëveshjes së kredisë (shpenzimet për shërbimet ndihmëse për marrëveshjen e kredise, në veçanti primet e sigurimit, përfshihen nëse shërbimi është i detyrueshem për të përfitur

	kredinë ose normën e interesit të aplikuar). Shembull i personalizur per NEI mund të merret pranë degëve tona.
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë	Kosto administrimi është 0-2% ndaj shumës së disbursuar
Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë	Nuk Aplikohen
Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale	Nuk ka shpenzime noteriale
Kostot në rastin e pagesave me vonesë	Penalitetet në rastin e pagesave me vonesë jane 1% e shumës së papaguar me bazë ditore (për cdo ditë, për shumën e papaguar nga dita kur pagesa duhet të ishte kryer deri në ditën e kryerjes së pagesës). Ky interes, në rast se nuk paguhet, do të konsiderohet shumë e pashlyer.

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

E drejta për t'u tërhequr	Konsumatori ka të drejtë për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë brenda një periudhe kohore prej 14 ditësh kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë ose nga data kur klienti merr dijeni për kushtet kontraktuale. Perpara ushtrimin te kësaj të drejte klienti njofton me shkrim Institucionin.
Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit	Klienti ka të drejtën të parapaguajë të gjithën ose një pjesë të shumës së principalit të kredisë së papaguar deri në atë kohë, plus interesin e arritur deri në datën e parapagimit, duke paguar një komision për shlyerje të parakohshme mbi shumën e parapaguar I cili është: <ul style="list-style-type: none"> • 1% te shumës së kredisë të paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit. • 0.5% (një përqind) të shumës së kredisë të paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është me e vogël se 1 vit Klienti duhet të njoftojë në mënyrë të përvokueshme Institucionin me shkrim 5 (pesë) ditë kalendarike para datës së parapagimit. Asnjë pjesë e kredisë që është parapaguar nuk mund të tërhiqet përsëri nga klienti.
Informimi në rast refuzimi të kredisë	MCA do të informojë konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës	Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim ndaj klienti do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me letër rekomande ose postë te regjistruar në adresat e depozituara në institucion .
Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt MCA	Klientët mund të paraqesin ankesë në tre mënyra komunikimi: <ul style="list-style-type: none"> • me shkrim pranë cdo dege të MCA shpk; • nëpërmjet adresës elektronike: info@mca.al • duke telefonuar numrat 042238092; 0684055570 (gjatë orarit zyrtar)
Periudha kohore gjatë së cilës MCA ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor * Jo me shume se 7 dite kalendarike nga marrja ne dorezim e formularit ne fjale nga klienti	Ky informacion është i vlefshëm prej datës .../.../... deri në datën .../.../....

Konsumatori
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(emër mbiemër, nënshkrimi)